



KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 68

Datë: 28.06.2019

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (d) nenit 40, paragrafi 40.2 pika (c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 25, paragrafit 2 pikës 2.3 së Statutit të Komunës së Ferizajt 01 nr. 50 të datës 28.06.2013 Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datën 28.06.2019, miraton:

V E N D I M

PËR MIRATIM NË PARIM TË KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE PËR PERIUdhËN 2020-2022

I

Me këtë vendim në parim miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për Periudhën 2020-2022.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për Periudhën 2020-2022, ku paraqiten në mënyrë të detajuar prioritetet e tanishme dhe afatmesme.

III

Konsultimet paraprake publike për Rregulloren e cekur në pikën I të këtij vendimi do të jetë në afat prej 15 ditë.


IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



Kristina Gashi Bytyçi



KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 69

Datë: 28.06.2019

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (c) dhe (d) nenit 68, paragrafi 68.3 të Ligjit Nr. 03 /L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) nenit 8, të Udhëzimit Administrativ nr. 1/2015 për Transparencë në Komuna, nenit 25, paragrafit 2 pika 2.1 dhe nenit 69, të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 nr. 50 të datës 28.06.2013 Kuvendi i Komunës së Ferizajt në seancën e mbajtur me datën 28.06.2019, miraton:

V E N D I M PËR KONSULLTIM PARAPRAK ME PUBLIKUN

I

MIRATOHET: Vendimi për dërgimin e Draft Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre për konsulltim paraprak me publikun.

II

Komisioni lidhur me vendimin e cekur në pikën I do të ofroj informata të nevojshme për opinion – qytetarët e interesuar, përmes formave të fushatave informative, kategorive me grupe të interesit dhe palët e interesuara për t'i diskutuar propozimet.

III

Konsultimet paraprake publike për rregulloren e cekur në pikën I të këtij vendimi do të jetë në afat prej 15 ditë.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



Kristina Gashi Bytyçi



KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 70

Datë: 28.06.2019

Bazuar në nenit 12, paragrafi 12.2 pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/ L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 5, paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit nr.06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës të datës 07 Marsit 2019, nenit 21 të Rregullores së QRK nr 23/213 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 10 paragrafit 1 dhe neni 25, paragrafi 2 pika 2.11 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me date 28.06.2019, miraton:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM TË PJESËVE TË NGASTRAVE KADASTRALE NR. 496-3, 499-0, 500-1 DHE 500-2 ZK FERIZAJ

I

MIRATOHET: Propozimi i Kryetarit të Komunës 10 – nr. 463-61 të datës 18.06.2019 për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm për pjesët e ngastrave kadastrale nr. 496-3, 499-0, 500-1 dhe 500-2 Z.K. Ferizaj si në vijim:

- Pjesa e ngastrës kadastrale 496-3 Z.K. Ferizaj në sipërfaqe prej 52 m², pronë shoqërore-Kooperativa Bujqësore;
- Pjesa e ngastrës kadastrale 499-0 Z.K. Ferizaj në sipërfaqe prej 168 m², pronë shoqërore, shfrytëzues Rushiti Xhevat –Qirambajtje 99 vite (Nuhi);
- Pjesa e ngastrës kadastrale 500-1 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe prej 202 m², prona “MABETEX Holding SH.A”;
- Pjesa e ngastrës kadastrale 500-2 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe prej 1472 m², pronë Shoqërore, shfrytëzues N.SH. Fabrika e Vajit.

II

Pjesët e ngastrave kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme prej 1894 m² do të shpallet interes i përgjithshëm.

III

Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm të këtyre pjesëve të ngastrave kadastrale të shënuara në pikën I të këtij vendimi është se:

- sipërfaqe prej 1588 m² do të shërbej për ndërtimin e nënstacionit NS 110/35/10(20) kv Ferizaj 3(Kastriot) si dhe tarabën për linjat e përcjellëse 110 kv;
- sipërfaqe prej 306 m² do të shërbejë rrugë për stacion.

IV

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Ferizajt, Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastër.

V

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në veb faqen e Komunës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Kristina Gashi Bytyçi

